Si lende e pare dhe e vetme per prodhimin energjise elektrike te HEC-it LEFTER 3eshte uji i cili sigurohet nga perroi I Radatit vend ku shtrihet dhe objekti. Sasia vjetore e ujit qe do te perdoret eshte percaktuar ne baze te studimit hidrologjik te perroit te Radatit i cili perveç te dhenave shumevjecare eshte pasuruar dhe me matje reale, per te arritur ne nje prurje llogaritese te vepres sa me optimale, pasi ne kete rast eshte dhe parametri kryesor qe percakton si kapacitetin prodhues te vepres edhe koston totale te ndertimit te saj.

HEC "LEFTER 3"

- ✓ HEC "LEFTER 3" do te kete nje pruje llogaritese prej $Q_{II}=0.44 \text{ m}^3/\text{s}$, e cila ne baze te kurbes se qendrueshmerise se prurjve per vitin mesatar, sigurohet per rreth 70 dite te vitit, ndersa per pjesen tjeter te viti hidrocentrali do te punoje me prurjen qe do kete perroi.
- ✓ *Volumi i rrjedhjes vjetore per vitin mesatar ne aksin e vepres se marrjes HEC LEFTER 3 eshte **11,801,639.36** m³/s.*
- ✓ *Volumi i rrjedhjes vjetore per vitin mesatar qe do te perdore HEC "LEFTER 3" eshte **7,789,081.00** m³/s.*
- ✓ *Shkalla e shfrytezimit te rrjedhjes ne aksin e vepres= 66.00 %.*



RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

Energjine elektrike gjate periudhes se funksionimit vepra e siguron vete pasi dhe produkti i saj eshte energjia elektrike. Lende djegse nuk ka pasi prodhimi e energjise behet ne menyre te paster nga renia e ujit e cila ve ne pune turbinen PELTON dhe energjia mekanike me anen te pajiseve teknologjike kthehet ne energji elektrike.

I-Aktiviteti te tjera qe mund te nevojite per zbatimin e projektit , si: ndertimi i kampeve apo rezidencave.

Nuk eshte enevojshme te ngrihen kampe apo rezidenca si gjate periudhes se ndertimit te vepres edhe gjate funksionimit te saj, pasi forca punetore qe do jete pjese e zbatimit te punimive apo dhe periudhes se oprimit te vepres do te jene nga zona perreth, dhe keshtu qe nuka ka nevojje per akomodimin e tyre ne rezidenca apo çadra.

m-Infomacion mbi lejet dhe licencat e nevojshme te projektit, ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin dhe licencimin e projektit.

Licencat qe marrin pjese ne project-zbatimin jane licencat e inxhinierit hidroteknik Fahri MAHO, inxhinierit elektrik: Leko BOLLANO, inxhinierit Gjeolog: Shpetim Skuka, ekspertit te mjedisit: Alfred LAKO.

Investitori deri tani ka bere aplikimin per te gjith lejat neper ministite perkatese dhe eshte ne pritje te marrjes se pergjigjs se tyre, ku disa nga ato jane perfunduar.

Kordinatat e veprave te HEC-it "LEFTER 3"			
Nr	Numri I pikes	Kordinata X	Kordinata Y
1	Vepra e marrjes 2A	X=4470048.10	Y=4444032.18
2	Dekantuesi+baseni 2A	X=4470087.75	Y=4443997.01
3	Vepra e marrjes 2B	X=4472286.16	Y=4444240.29
4	Dekantuesi+baseni 2B	X=4472259.69	Y=4444201.27
5	Godina e HEC-it	X=4471617.17	Y=4442475.32

Sistemi Koordinativ Shteteror,(Gauss Kryger)



RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

Pamje te vendit ku do te ndertohet HEC-i "LEFTER 3".



A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long vertical stroke.

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

3. Një përshkrim i analizës të paktën dy alternativave për zbatimin e projektit ose komponenteve të veçanta të tij (si aksesit rrugor, administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura, llojet e lëndëve djegëse , vendodhja e projektit etj.) si dhe sqarimi i arsyeve kryesore për alternativën e propozuar , duke marrë parasysh ndikimet në mjedis të secilës alternativë;


Varianti I

Gjate hartimit te projekt zbatimit eshte pare si mundesi krijimi I disa skemave hidroenergjitike duke patur parasysh per arritjen e skemes me te mire e cila do na jepte kushtet me te miar tekniko-ekonomike te vepres si dhe demin sa me te vogel mjedisor. Keshtu pervec skemes se project zbatimit te propozuar eshte pare si mundesi dhe skema e shfrytezimit te HEC-it me kanal derivacioni ne shpatin e majte te perroit te Radatit dhe pastaj me tubacion presioni ne shtrat te perroit por u vu re qe ne kete skeme kishim nje perfitim te energjise elektrike ne krahasim me variantin e propozuar, por nga ana tjetere do te kishim nje katastrofe mjedisore sepse ne kete shpat kemi te bejme me pyje me pisha te cilat per hapjen e kanalit me nje trase me gjeresi prej 4 m dhe nje gjatesi mbi 1 km do te kishim prishjen e tyre. Gjithashtu ne kete krah te shtrirjes se projektit mbas daljes se pyllit kishim prona private banoreve gje e cila e veshtiresonte edhe me shume zhvillimin e projektit.

Varianti II

Keshtu qe grupi I projektimit hartoi skemen ne projektin e propozuar me anen e te ciles kemi dy vepra marrje te cilat bashkohen me ane te derivacionit ne basen presioni te cilat shtrihen ne zona te zhveshura dhe pa peme, ku gjithashtu dhe tubacioni i turbinave shtrihet ndermjet kruurizit qe formojne keto dy dege te perroit e cila eshte edhe kjo nje zone e zhveshur, por gjithashtu ne baze te hartes kadastrale projekti shtrihet ne siperfaqe shteterore dhe jo private cka e ben me te lehte zhvillimin e projektit nga ana procedurale por dhe nga ana teknike ne krahasim me variantin e pare.





Skema e projektit zbatimit HEC "LEFTER 3".(Shih dhe projektin e propozuar)

4. Një përshkrim të gjëndjes dhe vlerave egzistuese të mjedisit që mund të ndikohen nga zbatimi I projektit të propozuar, duke përfshirë;

4.1. Përshkrim të karakteristikave fizike të zonës së projektit;

- **Përshkrim I faktorëve klimatikë;**

Pellgu ujembledhes i lumit te Vjoses ne zonen e Leskovikut, sipas ndarjes klimatike te Shqiperise, shtrihet kryesisht ne zonen kryesisht ne zonen klimatike Mesdhetare Paramalore jugore. Karakteristika kryesore te kesaj klime jane verat e thata dhe dimra te laget.

Temperaturat mesatare vjetore e kesaj zone luhatet rreth vlerave 10.5 ne rrjedhjen e sipërme deri ne 14.5°C ne rrjedhjen e poshteme ku ai bashkohet me lumin Vjose. Keshtu muaji më i ftohte i vitit eshte Janari ku temperaturat mesatare jane 2.1°C. Ndersa muaji me i ngrohte eshte muaji gusht me vlera te temperatures mesatare 21.0°C. Ekstremet absolute në këtë zone jane relativisht te theksuara. Kështu vlera minimale absolute e temperaturës së ajrit për të gjithë periudhën e regjistrimit është -16.2°C (14 janar 1968), ndërsa temperaturat maksimale absolute e vrojtuar ka qene 36.2°C (14 gusht 1957). Siç shihet vlera e temperatures se ajrit nuk e kalon

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

kufirin prej 36 °C. Keto shifra tregojne edhe njehere ndikimin e theksuar qe ka relievi ne vlerat e temperatures. Regjimi i reshjeve ne kete zone ka karakter mesdhetar, pra sasia me e madhe bie gjate periudhes se ftohte te vitit ndersa me pak reshje bien gjate periudhes se ngrohte. Mesatarisht ne kete pellg gjate nje viti bien 1120.0 mm reshje. E krahasuar kjo me vleren mesatare te territorit shqiptar (1400 mm) mund te themi se kejo zone eshte relativisht e thate. Po te studiojme shperndarjen brendavjetore te reshjeve ne kete zone verejme qe kjo shperndarje eshte e pabarabarte ne periudha te ndryshme te vitit. Sasia me e madhe e reshjeve bie gjate gjysmes se ftohte te vitit rreth 70%, nderkohe qe gjate muajve te veres sasia e tyre eshte me e vogel, rreth 30%. Kjo shperndarje lidhet me veprimtarine e theksuar ciklonare gjate muajve te ftohte, qe shoqerohet me mot me vranesira e reshje te bollshme.

Sasia me e madhe e reshjeve bie gjate periudhes se ftohte te vitit dhe muajt me më shume reshje jane nentor-dhjetor. Ndersa muaji me më pak reshje është korriku. Nder vecorite hidrologjike te pellgut te Lumit te Vjose zona Leskovik eshte numri konsiderueshem i diteve me bore. Duke patur parasysh vlerat e mesme te temperatures gjate muajve te dimrit qe arrihen ne kete zone, fenomeni i renijes se bores eshte i zakonshem. Mesatarisht ne kete zone vrojtohen pak jave me shtrese debore Mesatarja e shtreses maksimale te bores arrin ne kufijte 25-30 cm. Ndersa lartesia maksimale e shtreses se bores ka arritur vlere edhe mbi 1.2 m. Kjo tregon qe bora perben nje ushqim te konsiderueshem uxor per kete perrua sidomos ne pjesen e sipërme e ketij pellgu.

- ***Përshkrim gjeomorfologjik dhe I sizmitetit I zonës së projektit;***

Relievi i zones se ndertimit te HEC LEFTER 3 karakterizohet nga relief malor i thyer.

Zhvillimi gjeomorfologjik eshte kushtezuar me teper nga mbizoterimi i gerryerjes fundore ne krahasim me ate anesore. Ky fenomen, qe ne luginat ne formen e ngushtices te gerryera ne masivin shkembor behet shume demonstrative, dallohet mire edhe forma e luginave ne formacionin e tyre, ku format trapezoidale jane te ngushta dhe brigjet te rrepirshme dhe te larte. Aktualisht rajoni eshte ne ngritje, por ne menyre te diferencuar. Ky zhvillim gjeomorfologjik ka kushtezuar:

- se pari, qe trashesia e aluvioneve ne shtrat te lumit te jete e ceket apo te mungoje (intervai i lumit ne ngushtica),
- se dyti qe proceset karstike ne shkembinjte karbonatik te kene zhvillim te vonuar dhe te kufizuar.

- ***Përshkrim I gjeologjisë dhe tokës në zonën e projektit***

Ne drejtim te vleresimit gjeologjiko — inzhinierik te lugines, te zgjedhur per ndertimin e HEC LEFTER 3 themi se e vecante e kesaj zone eshte karakteri gravitativ dhe karstik i mbulesave gelqerore te moshes Cr- Pg₁₋₂. Ne zonen e ndertimit te veprave te HC dominojne depozitimet

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

terigjene. Relievi ne zona te vecanta eshte me deformime per shkak te erozionit e reshqitjeve te mbuleses deluvionale – aluvionale.

Veprat hidroteknike te Hydrocentralit LEFTER 3do te ndertohen ne luginen e perroit te Radatit, dege e Lumit te Vjoses.

Sipas variantit te mundsheme per studimin e shfrytezimit hidroenergjitik te zones per ndertimin e Hydrocentralit LEFTER 3veprat hidroteknike te tij do ndertohen ne zonat:

Veprat e marrjes

Vepra e marrjes se Hydrocentralit Lefter 3 do ndertohet ne zonen gjeologjike te Permetit, ne fshatin Radat. Vepra e marrjes do te ndertohet ne kuoten 472.50m.m.n.d dhe do te vendoset ne shkembinj terigjen te prekur nga fenomenet erozionale .

Tubacioni i turbinave

Tubacioni i turbinave per HEC-in Lefteri 3 eshte parashikuar prej celiku me nje diameter prej **D=600 mm** dhe nje spesor qe shkon deri ne **$\delta=8$ mm**. Gjatesia sipas profilit gjatesor del rreth **L=2030 m**. Ne 14 pozicione gjate profilit do te kete blloqe ancorimi. Renia neto eshte llogaritur te jete rreth **$H_{neto}=69.26$ m** ku renja bruto eshte **$H_{bruto}= 78.15$ m**. Tubacioni do te jete prej celiku me diameter **D=600 mm** te llogaritur pas nje analize tekniko-ekonomike ne paragrafet qe vijojne. Traseja do te kaloje ne shkembinj flishore ranoro- argjilor .

Treguesit kryesor te vetive fiziko - mekanike te shkembinjve terigjene te zones se ndertimit te vepres te marrjes te Hydrocentraleve Lefter 3 do te jene te njejte me ato te vetive fiziko - mekanike te formacioneve ku do ndertohet dekantuesi.

Baseni me presion

Baseni i presionit vendoset menjehere mbas dekantusit ne nje konstruksion me te ne kuoten e nivelit normal te ujit 472.15 dhe realizon hyrjen ne kushte te caktuara te prurjes ne tubacionin e turbines. Persa l perket morfologjise zona ku do te ndertohet baseni ne lumin Radat perbehet nga formacione flishore.

Ndertesa e centralit

Ndertesa e Centralit vendoset ne nje tarrace ne afersi te bashkimit te dy perrenjeve te me perroitin e macishtit ne nje hapsire te nevojshme qe lejon terreni ne kete zone. Kuota e shkarkimit eshte paracaktuar te jete **$\nabla shk=394.00$ m** duke marre parasysh edhe shfrytezimin optimal te kaskades se perroit te radatit. Ndertesa e centralit te HC do te ndertohet ne zone te mbushur me depozitime aluvionesh . Pjesa fundore e shpateve, ne nivelet e uleta te lugines eshte e mbushur me depozitime proluviale e kolviale shpatore me filtrueshmeri te larte.

- ***Përshkrim I ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në zonën e projektit***

Ujerat sipërfaqësor perbehen nga ujerat e perroit te Radatit,dege e lumit Sarandaporos dhe nga deget qe formohen nga shpatet e thepisuar te lugines se perroit te Radatit.

Ujerat nentokesor ndodhen ne sipërfaqen e lugines se perroit te Radatit dhe niveli i tyre rritet ne pranimin e reshjeve sepse mbulesa argjilore e shtresave mbrojtese ne kete zone eshte e vogel.

4.2. Përshkrim të biodiversitetit në zonën e projektit

- ***Përshkrim I habitateve kryesore në zonën e projektit si dhe harta ilustruese***

Flora dhe fauna:

Ekosistemet, habitatet dhe pejsazhet ekzistuese, statusi i mbrojtjes se tyre (i mbrojtur, vecanerisht i mbrojtur) dhe statusi i ruajtjes (i favorshem, i pafavorshem)



RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

prurja ambientale Qamb≥Q355 e cila meret direkt nga kurba e qendrueshmerise se prurjeve per vitin mesatar.

Po ashtu edhe fauna karakteristike e zones eshte e paprekshme nga ndikimet e ndertimit te ketyre kanaleve, pritave e tuneleve, per arsye se aktiviteti i ndertimit dhe shfrytezimit nuk demton as ne lloje e as ne numer elementet e flores dhe faunes, si pjese perberese e ketij rajoni. Pra, si perfundim theksojme se ndertimi i Hidrocentralit LEFTER 3 dhe shfrytezimi i tij nuk e demton floren dhe faunen e kesaj zone.

Ndertimi i Hidrocentralit LEFTER 3 do jete nje ndihme e madhe per kete zone per vete kushtet per kerkese te madhe per energji elektrike qe po kalon vendi yne dhe rajoni ne pergjithesi.

- ***Përshkrim i faunës në secilin habitat dhe statusit të ruajtjes kombëtar dhe ndërkombëtar të tyre;***

Mjedisi Tokësor dhe Ligatinor

Rajoni i Korces është i pasur përsa i përket Florës dhe Faunës. Ka pyje të pasura pishe, bredhi, ahu, murrizi, shelgu, plepi, lisi, Ne zonat pyjore ka bimesi endemike shume te pasur nga te cilat jane dhe bimet medicinale si: mellaga e eger, zhumbrika, kamomil, kokrat e dellinjes se zeze, xinxifja, fjerguri, lule basani e shume lloje te tjera.

Fauna gjithashtu është e pasur dhe përfaqësohet nga kafshë të tilla: ujku, dhelpra, çakalli, ariu, lepuri etj., zogjtë: fazani, thëllëza turtulli, pelikani, karabullaku etj., peshqit: korani, krapi, trofta, mërenga, ngjale, skobus, karras etj.

Karakteristika kryesore e zonës së marë në shqyrtim është se në një territor shumë të vogël takohen lloje të ndryshme ekosistemesh duke përfshirë ato malore, lumore, të ujrave të ëmbëla (e rezervuarë), si dhe ekosisteme bujqësore ose agro ekosisteme. Zona në të dy anët e Lumit te Radatit tipizohet për nga larmia morfologjike si dhe procese aktive të depozitimit të sedimenteve dhe grumbullimit, një rrjet interesant hidrologjik dhe sedimente fine që transportohen në shratin e gjërë.

Vegjetacioni tokësor në këtë zonë i përket kryesisht karakterit të Europës Qendrore Kontinentale, me prani të pak elementëve mesdhetarë. Formacionet bimore të tërësisë tokësore shprehin një larmi formash, duke u zhvilluar ne mjediset e ulta afër ujembledhesve dhe Perrenjve ku sistemet e kulturave bujqësore dominojnë, në rajonet me lartësi të mesme e të madhe, e deri ne zonat e kullotave alpine.



RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

Në fushat e ulëta dhe kodrat, janë përshkruar një larmi formash barishtore si më poshtë vijon: vegjetacioni i barishteve të këqija ndaj kulturave bujqësore, *vegjetacioni nitrofil*, dhe *vegjetacioni anash rrugor*, *vegjetacioni amofil*, i kullotave të ulta e kodrinave, vegjetacioni i livadheve mocalore, dhe vegjetacioni i sistemeve pyjore.

Duke u mbështetur në vëzhgimet e deritanishme, ekosistemet natyrore të kësaj zone përbëhen nga një tërësi nën habitatësh si ato të sistemeve të përhershme ujore, të kanaleve kullues e ujitës, ekosistemeve të rezervuareve, bankinave të sistemeve rrjedhëse ujore etj.

Bimët e rralla

Ekosistemet tokësore të zonës i përkasin nën ndarjes ballkanike të zonës së vegjetacionit Sub-Mesdhetar. Këtu mund të vecohen tre nenzona *fitoklimatike*, si më poshtë:

- zona e dushkut,
- zona e shkurreve
- zona e bimeve te uleta.

Masivet gëlqerorë malorë të majave te majeve perreth popullojë disa biotope të jashtëzakonshëm dhe me vlera për ruajtjen natyrore në nivel Evropian. Vrojtimit tregojnë se, këtu takohet një numër prej rreth 78 lloje të dendroflorës. Mund të presupozohet që këto lloje të takohen edhe në afërsi të rajonit në studim si një zgjatje e sistemit në drejtim të masiveve te kodrave perreth.

Brezi i zonës së dushkut nis nga lartësia 600 m deri në 1300 m. në pjesë e konsiderueshme e këtij brezi përdoret nga bujqësia. Pjesa e dendroflorës në këtë system dominohet nga llojet e dushkut (*Quercetum*) me *Quercus petraea*, *Q. frainetto*, *Q. pubescens* ose *Q. cerris*. Drurët e dushkut me *Ostrya carpinifolia* dhe *Carpinus orientalis*, duke treguar një tendencë për përzjerje *Ostryo-Carpinion orientalis* në nivelet më të ulta të lartësive, qe janë gjithashtu pjesë e kësaj zone.

Në vendet e thata dhe shkëmbore dominon *Quercus trojana* (*Quercetum trojanae*). Gjithashtu në mjedise të tilla të ngjashme shfaqet lloji drunor i venjës (*Juniperetum excelsae*). Duke u bazuar në faktin se sistemet drunore shpesh herë paraqiten të vecuara, si dushqet ashtu edhe venjat, në këto biotope hapësirat mbushen me barishte te tilla si *Stipa grasslands* (*Festucetalia*).

Në mënyrë rastësore në sipërfaqe të vogla janë instaluar nga ana e njeriut sisteme të pyjeve me pisha në brezin e dushkut, kryesisht afër qendrave të banuara.

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

Në pjesën e sipërme të brezit të dushkut takohen komunitete në larmi si *Festuco-Brometea*. Një përzierje e elementeve Kontinentale dhe sub Mesdhetarë është tipike në rastet e kalimit nga format kontinentale *Festucetalia* dhe *submediteranea Brometalia*. Zonat e lagura të rajonit ose anët lumore janë të varfëra në veshje dushqesh. Në vende të tilla sistemet e kufizuara ligatinore rrethohen nga kullotat e tilla si tipi *Arrhenatheretum* ose nga sistemet fushore.

Duke u mbështetur në vërtetimet e ndryshme, besohet se 25 lloje bimësh të florës lokale i takojnë listës të florës së kërcënuar të Shqipërisë. Nëntë prej tyre janë në nivelin e kërcënimit lokal dhe dy lloje trajtohen si endemike.

- ***Përshkrim i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj;***

Kjo zonë (Zona ku do të ndërtohet Hidrocentrali), nuk gëzon statusin e ndonjë kategorie të mbrojtur (sipas IUCN-s kategorizim i adaptuar nga vendi ynë), si dhe në afërsi të saj nuk ka të tilla me status mbrojtjeje, megjithatë në kuader të rritjes së siperfaqeve të konsideruara si zona të mbrojtura dhe që janë në liste për të marrë statusin e vecante të mbrojtjes, ky aktivitet mund të integrohet me keto zona me se miri pa e prishur rëndesinë e tyre. Gjate hapjes së trasese nuk mundet të takohen objekte dhe trashëgimi që bartin vlera kulturore

4.3. Përshkrimi i cilësisë së mjedisit dhe ndikimeve egzistuese

- ***Cilësia e ujërave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të vnm-së;***

Persa i përket akuifereve në këto rrjedhe ujore janë të tipit malor me klimë të ashper gjate dimrit dhe të fresket gjate verës. Në keto ujera verëhen lemyshqet dhe algat lumore që vishen në faqen e gureve. Perrenjte që formojnë Lumin Saranaporos dege e të cilirt është perroi i Radatit janë ndër deget me të rëndësishme dhe me ujeshmeri të lartë për zonën përreth.

Cilësia e ujërave të ujitjes nga perroi Radatit është e mirë dhe ato duhet të përdoren për ujitjen e bimëve që kultivohen në këto zona.

Nuk shkakton probleme të kripëzimit dhe toksicitet në bimët e ndjeshme, por mund të shkaktojë probleme të lehta të infiltrimit në tokë, duke ulur shpejtësinë e tij.

Probleme të lehta mund të paraqiten prej përmbajtjes relativisht të lartë të karbonateve dhe bikarbonateve në dëmtimin e strukturës së tokës.

Monitorimi i disa treguesve kimikë të ujërave në zone.

Rezultatet e analizave kimike të ujërave të lumenjve që përdoren për ujitje.



RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

Parametrat	Lumi Radat			
	M1	M2	M3	M4
Konduktiviteti elektrik	0.6	0.4	0.5	0.47
Kalcium	1.9	1	2.1	5.3
Magnez	4.1	2.4	2.7	3.1
Natrium	0.9	0.7	0.6	0.57
Karbonate	0.7	0.8	0.4	0.6
Bikarbonate	3	2.5	4.1	2.5
Klorure	0.3	0.7	0.9	0.4
Sulfate	0.5	0.9	0.5	0.7
Azoti - Nitrat	0.7	0.5	2	3.44
Azoti – Amonjakal	0.7	0.28	1.88	2.1
Fosfatet	0.06	0.07	0.10	0.04
Potasi	6.42	1.19	5.37	4.89
Aciditeti	7	6.3	7.8	7.9
Koficienti absorbues i Na+	0.58	0.39	0.4	0.37
Mbetje e thatë	0.49	0.3	0.1	0.2

Sasia e joneve të veçantë për perroin Radat jepet si më poshtë:

Vendmatja	Ca	Mg	Na	K	HCO ₃	Cl	SO ₄	Jone
Lumi Radat	34.2	20.07	4.21	0.93	210.07	9.07	15.03	297.45

Ujrat nentokesore

Gjendja e mire ekologjike do te perkufizohet ne baze te parametrave biologjike. Parametrat kimike, fizike dhe hidro-morfologjike konsiderohen vetem si mbeshtetes për zhvillimin dhe ruajtjen e gjendjes se mire biologjike. Megjithate, kalibrimi i vlerave te parametrave biologjike me vlerat limite për gjendje te mire biologjike dhe te tjera klasifikime nuk jane kryer ne Shqiperi dhe ne vendet antare te BE akoma është ne vazhdim. Ne kete situatë është e nevojshme te zbatohet

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

parametrat kimike dhe disa te tjerë fizike për te përcaktuar vlerat limite te kufijve, bazuar ne vlerësimin e eksperteve.

- **Cilësia e ajrit në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të vnm-së;**

Sipas **klasifikimit klimaterik** te vendit tone te bere nga Instituti Meteorologjik i Akademise ses Shkencave, zona ne te cilen mendohet te ndertohet HEC, sipas ndarjes klimatike te Shqiperise, shtrihet kryesisht ne zonen kryesisht ne zonen klimatike Mesdhetare Paramalore jugore. Karakteristika kryesore te kesaj klime jane verat e thata dhe dimra te laget.

- **Niveli I zhurmave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;**


Gjate ndertimit Hec LEFTER-3, do kete angazhim te makinerive per punime germimi, transporti etj. Per te zbutur efektin e trafikut te ngarkuar dhe te zhurmave qe e shoqerojne ate, me qellim uljen e shqetesimeve per popullaten qe jeton perreth zones se ndertimit te hidrocentralit, si rruge te perkohshme do te perdoren ku te jete e mundur rruget dytesore. Nga projekti jane parashikuar ndertimi i rrugeve ndihmese. Transportimi i materialeve te ndertimit ne rruget egzistuese do te programohet me kujdes per te shmangur cdo shqetesim ne trafikun lokal. Gjate nates, automjeteve do tu kerkohe te operojne me shpejtesi te ulta dhe te ndalohet perdorimi i borive. Zhurmat do të monitorohen sipas ditës e natës, për 8-orëshin gjatë ndërtimeve. Gjithashtu do të shihen se cilat pjesë përcaktojnë zhurmën, e cila qarkullohet vazhdimisht. Do të vërehen kriteret dhe normat që duhet të përcaktojnë zhurmat. Menaxheri i vendit të ndërtimit duhet të mbajë dokumentacion për çdo zhurmë gjatë procesit të ndërtimit. Zhurmat do të maten për një periudhë 1 vjeçare, kur parku të jetë në aktivitet të plotë.

- **Administrimi I mbetjeve në zonën ku propozohet projekti;**

Administrimi i mbetjeve te ngurta, gjate ndertimit dhe pas ndertimit te hec-it LEFTER 3do realizohen me sistem grumbullues dhe do trasportohen ne pikat me te aferta ne venddepozitimet e mbetjeve te ngurta te cilat jane vendosur ne zonat e caktuara nga organet e qeverisjes vendore.

- **Problem te tjera (nëse evidentohen) të tilla si erozioni I tokës , zjarret, ndotje historike etj;**

Ne ato zona ku ka probleme te erozinoit do meren masa:



RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

-**Masat agro-teknike** janë masat që janë të përshtatshme për të ndaluar ose zvogëluar erozionin dhe kështu ndalojnë ose zvogëlojnë humbjen e shtresës së pëlleshme të dheut nga toka bujqësore.

-**Drunjtë në brezin mbrojtës** janë një varg drunjesh ose shkurresh të cilat janë mbjell për të ndaluar ose zvogëluar ndikimin e erozionit nga era në rrafshina ose erozionit nga uji në shpate ose në rrafshina që vërshohen.

-**Nën mbjellja** është mbjellja e barit ose llojeve tjera të bimëve, të cilat mbulojnë dheun e zhveshur rreth të mbjellave (kulturave) të cilat nuk e mbulojnë tokën ose lënë hapësira të mëdha të zhveshura të dheut. Qëllimi i nën mbjelljes është të ndalohet humbja e shtresës së pëlleshme të dheut prej ndikimit të erozionit nga era dhe uji.

-**Bashkë mbjellja** është mbjellja e barit ose llojeve tjera të bimëve mes rreshtave të kulturave bujqësore kut të mbjellat nuk e mbulojnë dheun ndërmjet rendeve. Qëllimi i bashkë mbjelljes është që të ndalohet humbja e shtresës së pëlleshme të dheut nga ndikimi i erozionit të shkaktuar nga era dhe uji.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri do të realizohet sipas normave ligjore të Republikës së Shqipërisë, Evropës dhe normave e rregullave nga praktika teknike.

Mbrojtja nga zjarri është projektuar si instalim statik/fiks dhe do të lidhet në sistemin e hidrantit, i cili furnizohet me ujë nga depoja e ujit për zjarr-fikje. Kapacitetin dhe presionin në rrjetin e hidrantit e sigurojnë pompat të vendosura në stacionin e pompave. Në sistemin e mbrojtjes nga zjarri janë parashikuar këto masa teknike për mbrojtje nga zjarri:

- ➔ Furnizimi me ujë për nevojat e mbrojtjes nga zjarri.
 - ➔ Rrjeti i jashtëm i hidrantit me hidrantët mbitokësore dhe ormanët për hidrant.
 - ➔ Pajisjet statike për mbrojtje nga zjarri në çdo objekt.
 - ➔ Aparatet për zjarr-fikje.
 - ➔ Sistemi i alarmit të zjarrit (centrali) dhe lajmëruesit/detektorët në pika të ndryshme të instalimeve.
 - ➔ Butonat e alarmit në raste emergjente.
 - ➔ Pajisjet mobile për zjarr-fikje.
 - ➔ Mjetet për zjarr-fikje u mundësohet hyrjeve.
- **Presionet kryesore të mjedisit në zonën e projektit (të tilla si ndotjet e mjedisit, prerje pyjesh, etj.)**



a. Ndikime në vlerat e pejsazhit etj.

Ndikime në pejsazhet, vlerat rekreative, sociale dhe ndërkufitare

Vlera mjedisore/ Pejsazhesh	Vlera ekonomike (kullosore)	Aftësi rikrijuese dhe turistike	Vlera social edukative	Vlera ndërkufitare
***	****	***	***	***

* nuk ka ** të ulta *** mesatare **** të larte

b. Ndikime në florë dhe vegjetation

Periudha e punës së Hydrocentralit	Ndikime negative nga gëryerja	Ndikime negative të shkaktuara nga kimikate dhe hidrokarbure	Ndikime positive mbi florën dhe vegjetacionin
Faza fillestare	*	*	*
Marja e lëndëve të para	*	*	*
Ndikime pas 5 vjetësh	*	*	*
Ndikime pas masave rehabilituese	*	*	*

* nuk ka ** të ulta *** mesatare **** të larta

C. Ndikime në grupet kryesore faunistike

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LETTER 3

Periudha e punës së Hydrocentralit	Ndikime mbi gjitarët	Ndikime mbi shpendët	Ndikime mbi faunën peshkore	Ndikime mbi zvaranikët
Faza fillestare	*	*	**	*
Marja e lëndëve të para	* *(mbi brejtësit)	*	**	*
Ndikime pas 5 vjetësh	*	*	*	*
Ndikime pas masave rehabilituese	*	*	*	*

* nuk ka ** të ulta *** mesatare **** të larta

4.4. Përshkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti;

- **Njesia e qeverisjes vendor që administron zonën ku zbatohet projekti**

Zona ku do zhvillohet projekti i perket fshatit Radat, Komunes Leskovik te rrethit te Kolonjes qe i perket qarkut te Korces.

- **Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zones**

Popullsia me perafersi:

Të dhëna bazë per Rrethin e Kolonjes	
Sipërfaqja:	805 km ²
Banorë:	17.000 (2004)
Dëndësia e popullsisë:	65,33 ab./km ²
Pozita gjeografike:	Ne Jug-Lindje te Shqiperise
Lartësia:	2523 –Mali Gramozit
Zonat banuese	Ne 2 qytete dhe 6 komuna
Banore local afer H/C	1000 - 2000

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

Rrethi i Kolonjës është njëri nga 36-të rrethet e Shqipërisë. Rrethi bën pjesë në Qarkun të Korçës. Rrethi i Kolonjës ka rreth 17,000 banorë (sipas 2004), një sipërfaqe prej 805 km² dhe kryeqendër Ersekën.

Aktivitetet Ekonomike, Aktivitetet Bujqësore dhe Blektorale.

Ne fshatrat perreth, kesaj zone, historikisht dhe tradicionalisht, gje qe vazhdon edhe sot, ka gjetur zhvillim bujqesia dhe blektoria, por kohet e fundit nje vend te rendesishem po merr dhe sektori i sherbimeve, pasi zona shquhet per vlerat dhe potencialet turistike te saj. Nga aktivitetet e mesiperme popullsia mbulon 30-40% te nevojave ekonomike. Duke qene se banoret e kesaj zone cdo dite e me shume po largohen, si jashte shtetit por edhe drejt qytetit per mungese te vendeve te punes, hapja e nje aktiviteti do te zbuste sado pak plagen e emigracionit, e cila po ecen me ritme te shpejta kohet e fundit.

- ***Përdorimi I tokës në zonën e projektit***

Ndertimi i veprave hidroteknike te Hidrocentralit LEFTER 3 nuk krijon shqetesim per komunitetin perreth, si gjate fazes se ndertimit ashtu dhe ne fazen e shfrytezimit.

Punimet e ndertimit do te vazhdojne per nje periudhe te vogel kohe dhe nuk do te krijohen demtime te tokes.

Nuk ka mbetje demtuese ne siperfaqen ku do te vendosen pritat, ku do te hapen kanalet e tunelet dhe kanalet e sjelljes se ujit.

Per sa i perket tuneleve ato nuk japin ndonje ndryshim ne peisazh, per aresye se ato jane punime plotesisht nentoke dhe nuk duken ne siperfaqe Por duhet te theksojme qe permasat e ketyre kanaleve jane te vegjel me nje gjeresi 2 m dhe thellesi rreth 1,6 m, te cilet nuk duken nga larg dhe nga zonat e banuara, por vetem nga kalimtarët qe kalojne aty afer.

Per sa i perket ndertimit te ndertesës se Hidrocentralit LEFTER 3, vepra nuk do te vendoset mbi toke buke, por mbi taracen e vjeter te perroit (ne ane te majte te rrjedhjes) ne nje disnivel nga shtrati i sotem ekzistues, i cili nuk do te krijojë asnje problem ne rast reshjesh per kete ndertese.

Duhet te theksojme edhe njehere se i gjithë kompleksi i ndertimit te Hidrocentralit LEFTER 3 duke filluar nga veprat e marries, kanalet e sjelljes, dekantuesi, dhe ndertesa hidrocentralit nuk vendosen ne toke buke, por vetem ne shpate mali.

- ***Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike në afërsi të zonës së projektit***

Gjate hapjes se trasese nuk mundet te takohen objekte dhe trashegimi qe bartin vlera kulturore

- ***Administrimi I mbetjeve dhe ujërave të ndotura urbane***

Administrimi i mbetjeve te HEC-it LEFTER 3 do realizohen me sistem grumbullues dhe do transportohen ne pikat me te aferta.

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

Per ujerat e zeza do te perdoret gropa skeptike.

5. Një përshkrim të ndikimeve negative të rëndësishme të projektit të propozuar mbi mjedisin ku përfshihen;

5.1. Ndikimet negative në mjedis.

- **Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit;**

Ndikimet ne toke

Lloji i ndikimit në tokë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshime topografike të terrenit	+			+
Prishja e tokës bujqësore		+		
Ndotja e tokës nga rrjedhjet	+			+
Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta	+			+
Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave	+			+

- **Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së projektit.**

Ndikimet ne floren,faunen dhe gjeologjine

Lloji i ndikimit në florën dhe faunën	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore		+		+
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit		+		+
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zonës së virgjër		+		+
Përçarje apo izolim të habitateve të egra		+		+

- **Shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve;**

DERDHJA E PRODUKTIT NË MJEDIS

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

Kjo dukuri është shfaqja më flagrante dhe më e rëndomtë, por e ndjeshme ndaj tij, pasi edhe në sasi të vogël, e transportuar nga uji merr një përhapje të madhe dhe bëhet e pa rikuperueshme.

Derdhjet në mjedis mund të ndodhin vetëm aksidentalisht gjatë transportit me autoçisterna nga përplasjet e tyre eventuale.

Termi derdhje apo rrjedhje është fatal në shëndet e në mjedis, si dhe humbje ekonomike, prandaj është larg për kushte normale të operimit me këto produkte që punohet në siguri të lartë.

Aktiviteti	Parametrat e monitoruar	Kostot	Përgjegjësi
Matja e nivelit të zhurmave	<ul style="list-style-type: none">• Të bëhet një vëzhgim i strukturës së burimeve të zhurmave.• Realizimi i një harte të nivelit të zhurmave për objektin në fjalë.• Prespektiva e kontigjenteve të popullatës që preken.• Dhënia e sygjërimeve për problemet që mund të hasen	<ul style="list-style-type: none">• Personat të cilët duhet të angazhohen në matje duhet të jenë në profesionet: Njëri fizikant dhe tjetri laborant.• Duhet të parashikohet kostua për automjetin bashkë me karburantin për 7 ditë shërbimi në dispozicion.• Faza e dytë: Zhvillimi i matjeve	Kompania
Rezultatet e matjeve të hidhen në një raport niveli të zhurmave të matura	<ul style="list-style-type: none">• Data, vendi, ora e matjes, përshkrimi i kushteve meteorologjike, shpejtësia dhe drejtimi i erës.• Koha e referimit, e observimit dhe e matjes.• Zinxhiri i matjeve totale, duke përcaktuar këtu instrumentin e përdorur, gradën e saktësisë relative, çertifikata e vërtetësisë së tarimit, lloji i destinacionit të objektit për të cilin bëhen matjet, modeli, tipi, dinamika, përgjigjja në frekuenca në rast të përdorimit		Kompania

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

	<p>të një sistemi regjistruar ose riprodhues.</p> <ul style="list-style-type: none"> Lista emërore e specialistëve që kanë qenë prezent në matje, si dhe identifikimi dhe firma e specialistëve që kanë bërë matjet. 		
--	---	--	--

- *Ndikimet negative shtesë (kumulative) në cilësinë e mjedisit në zonën e projektit dhe burimet natyrore si mineralet , pyje, burimet ujore;*

Ndikimet ne uje

Lloji i ndikimeve në ujë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Trajtimi i ujërave të ndotur		↓	↓	
Ndotja e ujit prej pluhurit, acideve, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera		↓		↓
Ndikimi sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujërat nëntokësor etj.		↓	↓	
Modifikim në drenazhimin e ujërave natyrorë		↓		↓
Ndotja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor nga llumrat		↓		↓

Ndikimet ne ajer dhe ne klime

Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Prodhimi i aerosoleve		↓	↓	
		↓	↓	

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

- **Ndikimet sociale të projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet në mjedis të projektit (si zhurmat, pluhuri, përdorimi i burimeve natyrore etj.)**

NDIKIMET NË PËRFTIMIN E TOKËS

Lloji i ndikimeve në përfitim të tokës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrim banesash		↓		↓
Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës		↓		↓
Rivendosje banesash	↓		↓	
Shpronësime të tokës	↓			↓

NDIKIMET NË INFRASTRUKTURE.

Lloji i ndikimeve në interesin publik (Infrastrukturë)	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshimi i destinacionit të aktivitetit do të ketë ose jo nevojë për ndryshim në këtë fushë të interesit publik		↓	↓	
Energji elektrike		↓		↓
Sistemi i komunikacionit		↓	↓	
Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza		↓	↓	
Sistemi i ujësjellësit		↓		↓
Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre		↓		↓

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

NDIKIMET NË ENERGJINË

Lloji i ndikimeve në energji	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Përdorimi i sasive të mëdha të karburantit për energji		↓		↓
Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime ekzistuese të energjisë apo kërkesave për tipe të reja të energjisë	↓		↓	

NDIKIMET NË TANSPORT & QARKULLIM

Lloji i ndikimeve në qarkullim dhe transport	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shtime të rëndësishme të qarkullimit të automjeteve		↓	↓	
Pakësim të vend qëndrimeve të automjeteve, apo nevoja për vend qëndrime të reja		↓	↓	
Ndikime të rëndësishme në sistemin e komunikacionit		↓		↓
Ndryshime në qarkullimin apo lëvizjen e njerëzve		↓		↓

- ***Në varësi të natyrës të projektit një përshkrim i aksidenteve të mundshme me pasoja në mjedis;***

Hidrocentrali do të zhvillohet në harmoni me vlerat e natyrës. Brigjet dhe shpatet e maleve në zone përbejne habitate potenciale për biodiversitetin e pasur që mbartin.

Ndërtimi i veprave hidroteknike kërkon realizimin e shumë punimeve dhe ndërtimin e disa veprave (prita, kanali i marrjes së ujit, shtrim tubacionesh, ndërtim plintash, ndërtim godine të turbinave etj).

Vëmendje kryesore gjatë këtyre punimeve duhet të tregohet në dy aspekte

- 1) sistemimi i materialit inert të krijuar nga këto punime,
- 2) sistemimi i brigjeve dhe shpateve për të evituar fillimin e erozionit.

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

Studimi i hollesishem e strukturave gjeologjike, qedrushmerise se tyre dhe masave te propozuarar nga projektuesit e ketij hidrocentrali jane garanci qe keto probleme mjedisore do te jene minimale.

Pra mund te themi se nga ky aktivitet nuk pritet te kete ndikim mjedisor te matshem pasi:

- Nuk ka prodhim te mbetjeve te rrezikshme
- Nuk shkakton ndotje te tokes me shkarkime te ndryshme te lengeta, apo te ngurta
- Nuk ka shkarkime ne ajer te gazrave apo tymrave
- Zhurmat ne mjediset e punes do te jene brenda normes sanitare te lejuar, dhe per pasoje as zhurmat ne mjediset e jashtme nuk pritet te kene ndikim ne popullaten perreth
- Nuk ka clirim te aromave te ndryshme, etj
- Ka vlera normale te temperatures dhe te lageshtise ne mjediset e punes
- Jane parashikuar marrja e te gjitha masave per mbrojtjen ne pune dhe masat per evitimin e rrezikut te zjarrit

Shoqeria "MP ENERGY" sh.pk ka mjetet e nevojshme teknike dhe financiare per te zhvilluar kete aktivitet dhe kerkon te jete e pajisur me te gjitha lejet perkatese, sipas legjislacionit shqiptar.

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per ndertimin e **Hec LEFTERI 3**, eshte pergatitur si pjese e dokumentacionit qe duhet per te marre miratimet e zhvillimit te aktivitetit nga institucionet perkatese.

Raporti eshte pergatitur sipas kerkesave te Ligjit "Per Mbrojtjen e Mjedisit" dhe Ligjit "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis". Ai synon te jape aspektet mjedisore te aktivitetit dhe ndikimet e mundshme ne mjedis si rezultat i zhvillimit te tij.

Ne Raportin e Vleresimit Ndikimit Mjedis shoqeria "MP ENERGY" sh.p.k. jep informacionin e duhur:

- per aktivitetin qe eshte menduar te kryhet ne perputhje me kerkesat mjedisore,
- per zhvllhimin e aktivitetit te prodhimit te energjise hidro qe do te jete ne perputhje me kriteret per mbrojtjen e mjedisit.

5.2. Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis;

- **Metodat e zbatuara për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis;**

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte bazuar ne Strategjine Kombetare te Energjise me standartet bashkekohore, per zhvillimin e te gjithe sektoreve energjetike.

Qellimi i Strategjise se Energjise ka te beje me zhvillimin sa me efektiv te sektorit energjistik:

a) Garanton sigurine e furnizimit me burime energjetike.

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

b) Sektori energjetik eshte nje sektor mbeshtetes per nje zhvillim te qendrueshem te te gjithë sektoreve ekonomik.

Qellimi i hartimit te raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte marrja parasysh e faktoreve qe ndikojne ne mjedis gjate ndertimit te objektit dhe funksionimit te tij.

Ky raport eshte pjesa me e rendesishrne e dokumentacionit te kerkuar, ne zbatim te procedures se nevojshme gjate procesit te miratimit te lejes mjedisore. Raporti ka gjithashtu si qellim te jape nje veshtrim te pergjithshem mbi efektet ne mjedis, alternativat e mundeshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (VMM) eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjithë efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultonin nga nje projekt i propozuar, si gjate zbatimit ashtu dhe gjate funksionimit te tij. VNM-ja perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet:

- Marrjes ne konsiderate e ceshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimit cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt, etj.

Qellimi i ketij Raporti te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), i pergatitur per rastin e ndertimit te it LEFTER 3eshte qe te identifikojë pasojat e mundeshme negative mjedisore qe mund te krijohen gjate ndertimit dhe shfrytezimit te ketyre hidrocentraleve.

Gjithashtu nje tjetër synim i ketij Raporti te VNM-se eshte te percaktojë e te rekomandojë masat tekniko-organizative per zbutjen e faktoreve negative qe ekzistojne, dhe te atyre qe krijohen gjate ndertimit dhe shfrytezimit te tyre.

VNM-ja e ketij projekti eshte hartuar per te integruar mbrotjen ambientale ne jeten e perditshme, qe te udheheqë ne ndryshimin e sjelljes se komunitetit, duke u bere ne kete menyre forca shtytese e permiresimit te vazhdueshem.

Metoda me e pershtateshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis eshte ajo e list kontrollit, e cila vendos nga njera ane te gjitha burimet e mundshme te ndikimeve, dhe nga ana tjetër mbartesit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhesise se ndikimit.

- ***Shtrirja fizike dhe kohëzgjatja e ndikimeve të identifikuar (shkalla);***

Identifikimi i ndikimeve ne mjedis te veprimtarise dhe ceshtjet mjedisore qe do te trajtohen ne raportin e VNM-se.

Nr	Pyetje qe konsiderohen ne fazen e perzgjedhjes	Po /Jo	Cilet elemente te mjedisit mund te	Do te jete ndikimi domethenes ne
----	--	--------	------------------------------------	----------------------------------

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

			ndikojne e si?	mjedis? Pse?
1 A do te perfshije ndertimi, operimi ose mbyllja e vepimtarise dhe montimi i teknologjise dhe pajisjeve veprime qe te shkaktojne ndryshime fizike ne topografi, perdoim toke, ndryshime ne trupat ujore etj ?				
1.1	Ndryshime te perkoheshme ose te perhereshme ne pedorimin e tokes, mbulesen e tokes ose topografin, duke perfshire ritjen e intensitetit te perdorimit te tokes	Po	Pjese te tokes ku do ndertohen vepra hidroteknike	Jo (ndertimi i veprave do shoqerohet me rehabilitimin e tokes)
1.2	Pastrimin e tokes ekzistuese, vegjetacionit dhe ndertimeve ekzistuese?	Jo		
1.3	Krijimin e prdorimeve te reja te tokes?	Jo		
1.4	Investigime para fazes ndertimore , si shpime per marrjen e mostrave, provat e tokes, dheut ?	Po	Pjese te tokes ku do ndertohen veprat hidroteknike	Jo (shpimet gjeologjike do kryhen per llogaritjen e veprave hidroteknike)
1.5	Punime ndertimi?	Po	Ndertim i veprave hidroteknike	Jo (nuk do kete ndikim domethenes)
1.6	Punime prishjeje?	Jo		
1.7	Kantiere te perkoheshme pe punime ndertimi ose strehimi per punetoret?	Po	Ambiente shembimi per punetoret	Jo (do pershtaten shtepite e pabanuara)
1.8	Punime mbitokesore, struktura ose punime te tokes, germime ose mbushje?	Po	Punime mbitokesore	Jo (nuk do kete ndikim domethenes)
1.9	Punime nentokesore, miniera ose tunele?	Jo		
1.10	Punime bonifikuese?	Jo		
1.11	Germime per hapje kanalesh?	Po	Pjese te tokes kanaliderivacionit	Jo (nuk do kete ndikim domethenes)
1.12	Struktura bregdetare, si diga, skela?	Jo		
1.13	Struktura ne det?	Jo		
1.14	Procese te ndryshme prodhimi?	Jo		
1.15	Mjedise per magazinim te madhrave e materialeve te ndryshme?	Po	Nuk do kete ndikim ne mjedis	Jo (do perdoren ambiente ekzistuese)

RAPORTI THELLUAR I VNM PER HEC LEFTER 3

1.16	Impiante per trajtimin ose depozitimn e mbetjeve te ngurta e te lengeshme?	Jo		
1.17	Objekte per strehim te punetoreve shfrytezimit?	Jo		
1.18	Ruge e re, hekurudhe, trafik detar, gjate fazes se ndertimit e shfrytezimit?	Jo		
1.19	Ruge e re, hekurudhe, ajrore, ujore ose te tjera, perfshire dhe ruge e stacione te reja ose te alternuara porte e aeroporte?	Jo		
1.20	Mbyllje apo devijim i rugeve ekzistuese qe con ne ndryshime ne levizjet e trafikut?	Jo		
1.21	Linja e tubacione te reja te transmetimit?	Po	Nuk do kene ndikim mjedisor	Jo (nuk do kete ndikim domethenes)
1.22	Rezervuar, argjinatura, kanalenentokesore, regullime apo ndryshime te tjera ne hidrologjine e rjedhave ujore apo akuifereve?	Po	Rjedha e lumit	Jo (eshte kushtezuar plotesim i nevojave te komunitetit per uji)
1.23	Ndeprerje te rymave?	Jo		JO Do shfrytezoher deri 66% e prurjes se ujit ndersa ekologjike do te jete sipas legjislacionit ne fuqi Qamb≥Q355.
1.24	Nxjerje ose transferim te ujit nga nentoka ose siperfaqet ujore?	Po	Rjedha e lumit	JO Do shfrytezoher deri 66% e prurjes se ujit ndersa ekologjike do te jete sipas legjislacionit ne fuqi Qamb≥Q355.
1.25	Ndryshime ne trupat ujore ose siperfaqet e tokes qe ndikojne ne largimin e ujrave?	Jo		
1.26	Transportin e personelit e materialeve te ndertimit, shfrytezimit e mbeturinave?	Po	Nuk do kene ndikim mjedisor	Jo (nuk ka ndikim domethenes)
